



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 53 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 29/ 04 / 2024

VENDIM

Nr.12, date 29 /04/2024

PËR

**MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KOMITETIT
KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA TË SHQIPËRISË DHE KOMITETIT
KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA TË GREQISË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, pika a,c,d, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29.04.2024 mori në shqyrtim Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet KKDM dhe GRCOLD të paraqitur nga Kryetari i KKDM, z. Arjan Jovani.

Përmes Memorandunit të Mirëkuptimit do të bëhet e mundur krijimi dhe rregullimi i kushteve institucionale të bashkëpunimit ndërmjet dy Institucioneve homologe në fushën e sigurisë dhe monitorimit të digave dhe do të përcaktohen prioritetet bazë të këtij bashkëpunimi i bazuar në pavarësinë institucionale, respektin reciprok dhe parimeve universale të bashkëpunimit të pranuar nga të dy palët. Të dy Komitetet do të krijojnë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive në fushën e inxhinjerisë së digave.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

Të miratoj Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Komitetit Kombëtar të digave të mëdha të Shqipërisë (KKDM) dhe Komitetit Kombëtar të digave të mëdha të Greqisë (GRCOLD) sipas tekstit bashkëlidhur këtij Vendimi.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për arkivimin e këtij Memorandumi si dhe ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë dokument, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

